



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202002991/2

Tiranë ___/___/2020

Lënda: Rekomandojmë marrjen e masave për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 6/pika 3 dhe nenit 7/pika 3 të ligjit nr.93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar", i ndryshuar.

Drejtuar: **Znj. Ogerta MANASTIRLIU**
Ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

TIRANË

E nderuar Zonja MANASTIRLIU,

Në përmbushje të misionit kushtetues, si garant i mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe nxitës i standardeve më të larta të këtyre të drejtave, institucioni i Avokatit të Popullit, tregon një vëmendje të posaçme dhe me prioritet ndaj problematikave që ndeshin shtresat më të marginalizuara të shoqërisë shqiptare.

Në këtë kontekst, në këndvështrimin e mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, e gjejmë me vend t'u parashtrijmë sa më poshtë vijon:

Si një institucion që sipas ligjit nr.93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar", i ndryshuar, është monitorues i zbatimit të këtij ligji në përputhje me Konventën e OKB-së

“Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”, ka konstatuar se ende nuk kanë dalë të gjitha aktet nënligjore për ta bërë të zbatueshëm ligjin.

Në nenin 21 të ligjit të sipërcituar janë parashikuar afatet për nxjerrjen e akteve nënligjore. Konkretisht, sipas kësaj dispozite, thuhet shprehimisht:

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 13, pika 3, dhe 17, pika 2, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, aktet nënligjore në zbatim të neneve 8, pika 4, dhe 11, pika 3, brenda 6 muajve, si dhe aktet nënligjore në zbatim të neneve 6, pika 3, 7, pika 3, 10, pika 5, dhe 20, brenda 24 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit.

Rezulton se që nga hyrja në fuqi e ligji, datë 12.09.2014, ende nuk janë aktet nënligjore në zbatim të nenit 6/pika 3, nenit 7/pika 3:

Në nenin 6- **Shërbimet për një jetesë të pavarur**- pika 3, thuhet se:

“3. Rregullat, procedurat dhe kriteret e ofrimit të këtyre shërbimeve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Në nenin 7- **Vendimmarrja e mbështetur** –pika 3, thuhet se:

“3. Rregullat, procedurat dhe kriteret e ofrimit të këtyre shërbimeve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Jetesa e pavarur mundësohet nëpërmjet shërbimeve të ndryshme që synojnë të ofrojnë mbështetje në kapërcimin e barrierave. Sipas këtij ligji, shërbimet që mundësojnë jetesën e pavarur fokusohen:

- në nevojat e individit dhe në zgjedhjet e tij personale,
- mbulojnë në mënyrë gjithëpërfshirëse të gjitha sferat e jetës, përfshirë sferën e punës, arsimit dhe aktiviteteve shoqërore, profesionale dhe të kohës së lirë, si dhe të gjitha dëmtimet e nevojat për ndihmë që rrjedhin nga dëmtimi/aftësia e kufizuar,
- krijohen në formën e një shërbimi kontraktual ndërmjet individit me aftësi të kufizuara dhe ofruesit të shërbimit,
- janë nën kontrollin e personit me aftësi të kufizuara në cilësinë e konsumatorit,
- kanë procedura të qarta dhe transparente ofrimi;
- përfshijnë të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për të dhënë udhëzime;
- japin mundësinë për personat me aftësi të kufizuara që kërkojnë ndihmë që të mësojnë gradualisht si të japin udhëzime;
- synojnë zhvillimin e plotë të personalitetit të personave me aftësi të kufizuara në respekt të diversitetit.

Nxitja e pjesëmarrjes aktive të vetë personave me aftësi të kufizuara dhe përfaqësuesve të tyre, në të gjithë proceset e hartimit dhe zbatimit të legjislacionit dhe të politikave sociale bashkëkohore, duhet t'i shërbejë përgatitjes së personave me aftësi të kufizuara për një jetesë të pavarur dhe me dinjitet.

Personat me aftësi të kufizuara, të cilët kane nevojë për ndihmë në vendimmarrje, duhet të marrin mbështetjen e duhur nga një individ ose grup individësh. Ata kanë aftësinë për të marrë vendime me një mbështetje të duhur dhe nuk duhet t'u hiqet kapaciteti ligjor e t'u caktohet një kujdestar, i cili merr vendime në emër të tij. Kjo sjell diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar.

Sipas ligjit të sipërcituar, mbështetja mund të sigurohet në një sërë mënyrash, përfshirë mbështetjen me anë të interpretimit dhe gjuhës së thjeshtë, si dhe ndihmën në marrëdhëniet e personit me palë të treta, që nuk mund të kuptojnë mënyrat e tij të komunikimit.

Por, mosnxjerrja e këtyre akteve nënligjore, bën që të drejtat e personave me aftësi të kufizuara të parashikuara në dispozitat ligjore të sipërcituara të mos gjejnë zbatim.

Personat me aftësi të kufizuara duhet të konsiderohen bartës të të drejtave të tyre, bazuar në respektin, mbështetjen dhe diversitetin human, duke u krijuar kushtet e favorshme për integrimin e tyre në të gjitha sferat e jetës. Duhet kuptuar fakti se mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të tyre nuk ka lidhje vetëm me shërbimet e ofruara për aftësinë e kufizuar, por me miratimin e masave për të tejkaluar pengesat që parandalojnë pjesëmarrjen e plotë të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri.

Qëllimi i Konventës së OKB-së *“Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”*, është nxitja, mbrojtja dhe të sigurimi, që të gjithë personat me aftësi të kufizuara, të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre, për të balancuar disavantazhin e thellë shoqëror, në të cilën ndodhen personat me aftësi të kufizuara dhe të mundësojë pjesëmarrjen në sferat shoqërore, politike, ekonomike dhe kulturore me mundësi të barabarta.

Konventa e OKB-së *“Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar”* ka përcaktuar se:

- *“Shtetet palë marrin përsipër:*
 - (a) *Të mundësojnë të gjitha masat e duhura legjislative dhe administrative si dhe masa të tjera për zbatimin e të drejtave të njohura nga kjo konventë”*”.

Avokati i Popullit ka vlerësuar angazhimin dhe punën e deritanishme të institucionit që Ju drejtoni, por gjykon nevojën për të bërë të zbatueshëm ligjin në këtë situatë pandemie që po kalon vendi ynë, me qëllim respektimin e të drejtave për barazi të personave me aftësi të kufizuara.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 118 ka përcaktuar se, *aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet përkatëse dhe në këtë rast, organi i cili duhet të nxjerrë aktet nënligjore të sipërcituara është Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale.*

Garantimi i jetesës së pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara që zgjedhin të jetojnë në mënyrë të pavarur, është një nga objektivat e ligjit nr.93/2014 “*Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara*”, i ndryshuar. Në nenin 1, pika b, thuhet shprehimisht se:

- ***Përcaktimet për garantimin e jetesës së pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara që zgjedhin të jetojnë në mënyrë të pavarur, duke rritur në maksimum autonominë e tyre dhe vendimmarrjen e pavarur, me synimin për të garantuar jetën në komunitet në kushte të barabarta me të tjerët.***

Për sa më sipër, duke vlerësuar të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, si një prej çështjeve më të rëndësishme të një shteti social, në mbështetje të pikës 3 të nenit 63 të Kushtetutës, ku thuhet shprehimisht se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*”, dhe në vijim të nenit 21/b ku thuhet se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*”

REKOMANDOJMË:

Marrjen e masave për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 6/pika 3 dhe nenit 7/pika 3 të Ligjit nr.93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, i ndryshuar.

Në përputhje me nenin 22 të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, plotësuar me Ligjin nr.8600 datë 10.04.2000, ndryshuar me Ligjin nr.9398, datë 12.05.2005, ku thuhet shprehimisht se;

“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”, lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin Tuaj ndaj këtij rekomandimi, brenda 30 ditëve”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj, mbetemi në pritje të përgjigjes.

Me respekt

AVOKATI I POPULLIT

Erinda BALLANCA